

THIRRJE PËR PROJEKT ARTISTIK

Në kuadër të përmbushjes së misionit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës, bazuar në Ligjin nr.115, datë 18.12.2017 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, i përditësuar, në vijimësi të programit vjetor të saj “Ditët e Shqipërisë” me komunitetin shqiptar në Greqi, Agjencia Kombëtare e Diasporës shpall thirrjen për organizimin e aktivitetit artistik “Tingujt e vendit tim” me bashkëpunorë të jashtëm, në kuadër të aktiviteteve “Nëntori Shqiptar”, planifikuar për t’u zhvilluar me datë 28-29 Nëntor, nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Greqi.

Ky aktivitet ka për qëllim prezantimin e kulturës shqiptare në rajonin ku do të zhvillohet, duke krijuar një urë lidhëse të rëndësishme të mardhënieve shqiptare me ato të vendit fqinj Grek.

Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 403, datë 30.06.2021 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme, kritereve dhe procedurave specifike për marrjen me qira të ambienteve dhe lidhjen e kontratave të veçanta me bashkëpunorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë, të cilat nevojiten të kryhen me qëllim zbatimin dhe realizimin e programit vjetor të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe që nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik”, Agjencia Kombëtare e Diasporës shpall thirrjen për pjesmarrje të palëve të interesuara (bashkëpunorë të jashtëm) që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Të kenë marrë pjesë në aktivitete të mëparshme;
- b) Të kenë dhënë kontribut për vendin e origjinës;
- c) T’u jenë akorduar çmime kombëtare apo ndërkombëtare;
- d) Të ketë ekspertizë në fushën për të cilën zhvillohet aktiviteti.

Në lidhje me aktivitetin duhet të plotësohen kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

Projekti duhet të konsistojë në një formacion orkestral të nivelit të lartë të muzikës instrumentale shqiptare, në rang vendi, ku do të prezantohet për publikun e gjërë shqiptar e të huaj në Greqi.

Organizimi i aktivitetit artistik duhet të konsistojë në ndërthyerjen e instrumentave si: orkestër harqe, piano, klarinetë, fyell, fizarmonikë, si dhe instrumenta të tjerë muzikorë.

Aktivitet artistik duhet të ketë si qëllim primar vendosjen dhe konsolidimin e mardhënieve ndërmjet Komunitetit Shqiptar në Greqi, i cili për nga numri është komuniteti më i madh, me vendin e origjinës Shqipërinë nëpërmjet “Artit”, duke përmbushur misionin e vetë Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Projekt propozimet si dhe situacioni financiar duhet të paraqiten brenda datës 18.11.2021, ora 16:30.